


# TRIBUNA SINDIKALE



Dhjetor 2014

*Dhe drit e diturisë  
përpara do na shpjerë*



**Editorial****FSASH DHE SPASH KUNDER  
TESTIMIT TE MESUESVE**

Keto dite eshte folur e po flitet shume lidhur me prononcimin e Ministrise se Arsimit dhe Sportit per te bere nje testim te te gjithes mesuesve te sistemit te arsimit parauniversitar ne periudhen maj-qershor 2015. Perfaqesues te dikasterit, ne periudha te ndryshme gjate muajve nentor-dhjetor, kane bere deklarata te ndryshme dhe shpesh kontradiktore lidhur me kete ceshtje. Ne fillim u tha se testi synonte te kontrollonte aftesite e mesuesve dhe se ata qe nuk do ta fitonin ate, do te linin vendin e punes. Kjo shkaktoi pakenaqesi, shqetsim e frike midis mases se mesuesve. Mbas reagimit te FSASH dhe SPASH si dhe prononcimit te shume mesuesve, ne disa ballafaqime ne media, MAS deklaroi se **testimi do te jete nje fotografim i nivelit aktual te situates se kualifikimit te mesuesve dhe se testi do te sherbeje per te percaktuar nevojat per kualifikim te cdo mesuesi dhe jo per t'i larguar ata nga puna.**

Perballe kesaj gjendjeje, FSASH/SPASH, me statusin e partnerit social, si sindikatat me perfaqesuese ne sektorin e arsimit, **jane treguar te gatshme te negocojne me MAS per te gjetur rruget me te efektshme dhe ligjore per zhvillimin profesional te mesuesve dhe njekohesisht jane shprehur hapur kunder testimin, si nje mase qe nuk e zgjidh problemin.**

FSASH dhe SPASH jane shprehur kunder kesaj forme testimi jo se ato injorojne apo nenvleresojne kualifikimin e mesimdheseve, mbasi njihen angazhimet e tyre per arsim cilesor, pra edhe per mesues cilesor, por sepse ato kane argumentuar dhe argumentojne ne menyre bindese se testimi qe kerkohet te behet eshte joefektiv dhe, per me teper, i kunderligjshem.

Eshte i kundraligjshem, se nje testim i tille bie ndesh me dispozitat e shprehura te Ligjit 69/2012 "Per Sistemin Arsimor Parauniversitar ne Republiken

e Shqiperise". Ne nenin 58, pika 1 te ketij ligji thuhet shprehimisht se: "Institucioni arsimor, ( pra shkolla dhe jo Ministria), planifikon zhvillimin profesional te mesuesve, sipas nevojave te tyre dhe ne perputhje me politikat arsimore qendrore, vendore dhe te institucionit".

Kuptimidhe synimii kesaj dispozite eshte i qarte: nevojat e mesuesve per kualifikim te vazhdueshem, per perditesimin e dijeve, jane te padiskutuesdhme. Por keto nevoja nuk jane uniforme, perkundrazi, ato jane konkrete, janesipas niveleve te zhvillimit te arsimit, sipas lendeve mesimore, sipas zonave urbane ose rurale, etj. Pra, nevojat per trajnim te mesuesve evidentohen me mire se kudo ne nivel shkolle, ato percaktohen me parametra konkrete, midis te cileve, pervec atyre qe kerkon vete mesuesi, perfshihen edhe indikator te tjere, si rezultatet e krahasuara ne mesimdheneie e nxenie ne nivel shkolle, marredheniet mesues- nxenes dhe mesues prinder, etj.

Pikerisht per kete arsye ligjveneri me dispozite te vecante, ( neni 58, pika 2 e ligjit ) ka percaktuar taksativisht format e zhvillimit profesional te mesuesve, kur disponon se "Format e zhvillimit profesional jane: zhvillimi i brendshem profesional, trajnimet, rrjetet profesionale, keshillimet, kurset afatshkurterat dhe ato afatgjata".

FSASH/SPASH, qe jane pjesemarrere aktive ne hartimin e dispozitave ligjore per zhvillimin profesional te mesuesve, dispozita qe u cituan me siper, kane qene dhe jane te hapura per te bashkepunuar me punedhenesin, me MAS, per te percaktuar dhe perdorur format me te efektshme per zhvillimin profesional te te gjithes mesimdheneesve, si kushti kryesor per te arritur qellimin e perbashket: **ofrimin nga cdo institucion arsimor te nje mesimdheneieje cilesore per te gjithes nxenesit ku mesojne dhe jetojne.** Ja pse FSASH/SPASH kane kundershuar dhe kundershtojne nje testim formal te mesuesve.

**PERMBAJTJA***Editorial:*

- ✓ Vizita e delegacionit te Sindikates Gjermane te Arsimit, GEW, ne vendin tone **2**
- ✓ Nga mbledhja e Keshillit Drejtues te FSASH **3**
- ✓ Nga mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH **5**
- ✓ E ardhmja e Profesionit te Mesuesit, (Konkluzione nga Konferenca e ETUCE) **5**
- ✓ Nga Fjala e Sekretarit te Pergjithshem te EI, Fred van Leeuwen, ne Konferencen e ETUCE **15**
- ✓ Takime me prinderit ne shkollat «Naum Veqilharxhi» dhe «Shkolla e Re» ne Korce ne zbatim te Projektit me AOb **17**
- ✓ Takime me prinderit ne shkollat "Ahmet Zogu" dhe "Halit Çota", Bathore, ne kuadrin e Projektit me GEW, Gjermani **18**
- ✓ Homazh mikut tone te paharruar, Sotir Budo **19**

**Kopertina e pare:**

*Nga vizita e delegacionit te Sindikates Gjermane te Arsimit, GEW, ne shkollat "Ahmet Zogu" dhe Halit Çota" Bathore*

**Kopertina e fundit:**

*Nga aktivitetet e zhvilluara ne zbatim te Projektit me Sindikaten Holandeze te Arsimit, AOb, ne shkollat e Korçes*

**TRIBUNA SINDIKALE****Nr. 49****Dhjetor, 2014***Botim i FSASH dhe SPASH***ADRESA :**

*Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe Fakultetit Juridik, Kati i 3-te, Tirane*

*Tel & Fax + 355 4 225 65 32*

*Celular: + 355 68 20 34 674,*

*+ 355 69 22 69 795, + 355 68 21 52 891*

*E-mail: fsash@abcom-al.com*

*Internet: www.fsash-spash.com*

## Vizite e rendesishme e delegacionit te Sindikates Gjermane te Arsimit, GEW, ne vendin tone

Pas nje bashkepunimi prej disa vitesh dhe pas mbeshtetjes per zbatimin e nje Projekti ne dy shkollat, "Ahmet Zogu" dhe "Halit Cota" ne Bathore, per uljen e braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve, nje delegacion i Sindikates Gjermane te Arsimit, GEW, i kryesuar nga Presidentja e kesaj organizate, Zj. Marlis Tepe, dhe

seksioneve sindikale te FSASH e SPASH ne Durres, si edhe nje takim me Drejtoreshen e Kabinetit te Ministrise se Arsimit dhe Sportit, Zj. Adriana Berberi.

Qe ne fillim te takimit me perfaqesues te sindikatave shqiptare te arsimit, FSASH dhe SPASH, Zonja Marlis Tepe, shprehu kenaqesine qe ndodhej midis perfaqesuesve

te arritjeve te ketyre koheve te fundit, problemeve me te cilat ato po ndeshen, si edhe me sfidat kryesore perpara te cilave ato ndodhen, duke u fokusuar sidomos tek bisedimet dhe neshkrimi i Kontrates se re Kolektive te Punes, te ciles i mbaron afati ne fund te dhjetorit, si edhe tek ideja e MAS per testimin e te gjitha mesuesve ne vendin



me pjesemarrjen e Keshilltares se saj, Zj. Elina Stock, vizitoi sindikatat tona te arsimit, FSASH dhe SPASH, nga data 7 deri ne daten 9 dhjetor 2014.

Me kete rast, u organizuan disa aktivitete te rendesishme, midis te cilave permendim Takimin zyrtar me drejtues kryesore te FSASH e SPASH, ne ambientet e zyrave te tyre, takime te vecanta ne shkollen "Ahmet Zogu" dhe shkollen "Halit Cota", ku FSASH dhe SPASH jane duke zbatuar Projektin per mbajtjen e nxenesve ne shkolle dhe eliminimin e punes se femijeve, takime me perfaqesues te

te ketyre sindikatave dhe perseriti anagzhimin e sindikates gjermane qe drejton per te mbeshtetur FSASH dhe SPASH ne misionin e tyre per mbrojtjen social ekonomike te anetarve te tyre, per zhvillimin progresiv te sistemit arsimor ne Shqiperi dhe per mobilizimin e mesuesve e aktoreve te tjere per mbajtjen e te gjitha nxenesve ne shkolle dhe eliminimin e punes se femijeve.

Ne vijim, kryetaret e FSASH e SPASH, Z. Xhafer Dobrushu dhe Z. Nvrus Kaptelli, bene nje ekspozite te situates aktuale te punes dhe aktiviteteve te ketyre sindikatave,

tone, per te cilen dy sindikatat tona te arsimit jane shprehur kunder, duke patur parasysh mungesen e legjislacionit dhe te eficences se kesaj metode, nderkohe qe legjislacioni shqiptar percakton qarte menytrat se si realizohet trajnimi dhe kualifikimi i mesuesve.

Nje vend te rendesishem ne kete bashkebisedim miqesor, zune zhvillimet e reja ne mardheniet e bashkepunimit midis FSASH e SPASH, te konkretizuara me krijimin e Aleances Sindikale, gje e cila u pershendet nga drejtueset e

*Vijon nga faqja 3*

GEW, si nje hap i rendesishem per levizjen sindikale shqiptare, dhe per te ardhmen e sigurte te FSASH dhe SPASH. Partneriteti social me MAS, roli i dy sindikatave tona te arsimit ne procesin e reformave ne sistemin arsimor, angazhimet e perbashketa dhe mbeshtetja per njeritjetrin ne nivel europian e racional etj, ishin, gjithashtu, objekt i rendesishem i bisedimeve ne kete takim.



Zonja Marlis Tepe vleresoi angazhimet e FSASH dhe SPASH, duke i konsideruar disa prej tyre edhe si shembull ne rajon e me gjere dhe premtoi vazhdimin e bashkepunimit dhe te mbeshtetjes se sindikates qe ajo drejton per dy sindikatat tona te arsimit edhe ne te ardhmen.

Shume te rendesishme ishin takimet qe u zhvilluan me mesuesit, nxenesit e prinderit e angazhuar ne aktivitetet dhe punen konkrete per realizimin e objektiveve te Projektit qe FSASH e SPASH jane duke zbatuar ne shkollat "Amet Zogu" dhe "Halit Cota" ne

Bathore.

Drejtuesit e grupeve te Monitorimit te ketyre shkollave, Bukurosh Hoxha, ne shkollen "Ahmet Zogu" dhe Hysen Koldashi, ne shkollen "Halit Cota", informuan gjeresisht mbi masat e marra, punen e bere rezultatet e arritura dhe synimet kryesore per real izimin e objektiveve te Projektit. Mesues, nxenes e prinder, anetare te Grupeve te Monitorimit, qe e moren fjalën, sollen eksperiencen e tyre ne punen

lis Tepe, vleresoi shume pune e bere dhe rezultatet e arritura dhe premtoi se Gew do te vazhdoje te mbeshtese dy sindikatat shqiptare te arsimit, FSASH dhe SPASH, sidomos ne angazhimet e tyre per mbajtjen e nxenesve ne shkollë dhe eliminimin e punes se femijeve

Me shume rendesi ishte, gjithashtu, Takimi i zhvilluar ne MAS me Drejtoren e Kabinetit, Zj. Adriana Berberi, e cila e informoi drejtuesen e larte te sindikates se arsimit te Gjermanise, per angazhimet e MAS per nje reform te thelle e teresore ne sistemin arsimor shqiptar, per partneritetin social dhe mbeshtetjen e sindikatave te arsimit ne kete proces, si edhe per disa nga problemet me te cilat po perballet MAS dhe DAR e ZA ne kushtet aktuale te zhvillimit te sistemit arsimor ne vendin tone.

Presidentja e GEW, Zj. Marlis Tepe, pasi vleresoi anagzhimet e MAS dhe mbeshtetjen e FSASH e SPASH ne kete proces, solli pervojen e sindikates Gjermane ne lidhje me partenritetin dhe bashkepunimin me Minsitrine e Arsimit dhe organet arsimore ne landet e Gjermanise, trajtoi edhe problemin e idese per testimin e te gjithë mesuesve, duke e konsideruar ate nje veprim qe, jo vetem nuk ndihmon rritjen e rolit te mesuesve per arsim cilesor, por perkundrazi mund te kete nje rol negativ ne lidhje me vleresimin e rolit te mesusve si vizionare per detyren e rendeishme qe kane marre persiper.

Gjate qendrimit ne vendin tone delegacioni i GEW pati edhe nje takim informel me dy drejtuesit e seksioneve sindikale te FSASH e SPASH ne Durres dhe beri vizita ne Amfiteatrin e Durresit dhe ne Kalane dhe pazarin e Krujes.

konkrete individuale me nexenesit qe kane braktisur shkollen, ose qe jane ne rrezik per ta braktisur ate, objekt i punes ne kuader te ketij Projektit. Drejtoret e Shkollave, Azem Kovaci, shkolla « Ahmet Zogu » dhe mahmut Ajazi, shkolla « Halit Cota », vleresuan punen e mesuesve, nxenesve e prinderve dhe falenderuan Presidenten e sindikates Gjermane te arsimit, Zj. Marlis Tepe, per mbeshtetjen per zbatimin e ketij Projektit ne shkollat e tyre dhe premtuan se do te bejne te gjitha perpjekjet qe objektivat e Projektit te realizohen e te jkalohen.

Presidentja e GEW, Zonja Mar-

## SFIDAT E VITIT 2015

### Nga mbledhja e Keshillit Drejtues te FSASH

Me 19 dhjetor 2014 zhvilloi mbledhjen e tij te fundit per kete vit, Keshilli Drejtues i FSASH. Ne mbledhje moren pjese kryetaret e seksioneve sindikale dhe anetare te tjere te KD nga 32 rrethe te vendit.

Tema qendrore rreth se ciles u perqendrua mbledhja e Keshillit Drejtues ishte pergatitja per negociimin dhe nenshkrimin e Kontrates se re Kolektive te Punes te nivelit te pare.

Bazuar ne konkluzionet e grupit te punes dhe te Kryesise se FSASH per kete ceshtje, Keshilli terhoqi vemendjen ne disa nga problemet thelbesore qe lidhen me mbrojtjen sociale – ekonomike te sindikalisteve dhe gjithe mesuesve dhe, lidhur ngusht me kete, angazhimin e strukturave sindikale ne procesin e reformimit e modernizimit te sistemit te arsimit ne pergjithesi dhe atij parauniversitar vecanrisht.

Disa nga keto probleme thelbesore, qe ne te vertete perbejne edhe sfidat e FSASH per vitin 2015, jane :

1. Kontrata e re Kolektive do te jete rezultat i arritjeve sindikale te garantuara me kontratat e mepareshme kolektive, i

lirive dhe te drejtave sindikale te fituara me keto kontrata dhe me levizje sindikale. Midis lirive dhe te drejtave te fituara dhe te garantuara me dispozitat e Ligjit 7961 date 12.7.1995 “ Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), eshte edhe sistemi i pagave dhe i shperblimeve. Ne kete pike KD u ndal vecanrisht ne rastin e mosdhenies se shperblimit vjetor per mesuesit per vitet 2013-2014, terhoqi vemendjen e Kryesise per nje qendrim me te prere dhe me te ashper ne raste te tilla dhe, duke sjelle ne mbledhje pakenaqesine dhe kerkesen unanime te te gjithe sindikalisteve, theksoi njezeri qe raste te tilla nuk do te lejohen te perseriten ne te ardhmen.

2. Zbatimi i dispozitave te ligjit 69/2012 Per Sistemin Arsimor Parauniversitar per punesimin e mesuesve dhe zhvillimin profesional te tyre, nepermjet zberthimit dhe pasqyrimet te hollesishem te frymes dhe dispozitave konkrete te ligjit, duke ndertuar nje kuader kontraktual qe te garantoje punemarresit per nje proces transparent dhe bashkekohor punesimi, kualifikimi dhe te ruajtjes se vendit te punes.

Ne funksion te objektivit kryesor te sindikatave per 10-15 vitet e ardhshme: “ Te bashkohemi te gjithe per arsim cileor, per krijim shansesh te barabarta per te gjithe”, FSASH te organizoje, ushqeje dhe drejtoje nje dialog te gjere, qe te perfshije gjithe masen e sindikaliste “per te ardhmen e profesionit te mesimdhenes”, per mbrojtjen dhe vleresimin me mire te ketij profesioni.

3. Pasurimin dhe thellimin e pervojës se zhvillimit dialogut social me punedhenesin per ta bere ate me real, te pergjegjshem e te vazhdueshem dhe per ta shtrire ne te gjitha nivelet, duke filluar nga institucioni arsimor, njesite arsimore vendore e deri ne nivelin qendror.

4. Keshilli Drejtues vendosi qe veprimtarite sindikale te vitit 2015, te harmonizohen e zhvillohen ne kuadrin e objektive vizionare te Kongresit 6-te zgjedhor te FSASH dhe Kongresit te 7-te te Federates Nderkombetare te Sindikatave te Arsimit, EI.

## U MBLODH KESHILLI KOMBETAR I SPASH

Më 20 dhjetor 2014 në ambientet e Hotelit “Palma”, në Tiranë u mbledh Këshilli Kombëtar i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, (SPASH)

Në mbledhje u trajtuan problemet e mëposhtme:

1. Analizë vjetore e punës dhe veprimtarisë së SPASH për vitin 2014,
2. Miratimi i zërave të shpenzimeve dhe veprimtarisë për vitin 2015,
3. Të ndryshme.

Në fjalën e tij, nëpërmjet materialit të përgatitur për analizën vjetore të vitit 2014, Presidenti i SPASH, Z., Nevrus Kaptelli, ndër të tjera, u ndal në gjendjen e strukturave dhe shtrirjen e tyre në çdo rreth, funksionimin e aleancës

sindikale, veprimtarinë, kuotizacionet, partneritetin me punëdhënësin etj.

Midis të tjerave, ai theksoi: Megjithë takimet e herëpashershme të zhvilluara me MAS, konstatojmë se partneriteti dhe dialogu social midis palëve është në një nivel më të ulët se vitet e shkuara, kjo si pasojë e mosvlerësimit sipas ligjit e partnerëve socialë nga ana e MAS, që ka sjellë nxjerrjen e urdhërave e udhëzimeve pa u konsultuar më parë me sindikatën. Këtë shqetësim e kemi ngritur dy herë në Këshillin Kombëtar të Punës ku ne jemi anëtarë, por reagimi ka munguar nga ana e MAS.

Me DAR/ZA paraqitet pothuaj e njëjta gjendje, po këtu, jo vetëm për

mosvlerësim nga ana e tyre, por edhe nga disa këshilla sindikale të rretheve, të cilat nuk kanë funksionuar normalisht gjatë këtij viti.

Në ato rrethe ku kryesia e sindikatës ka qënë në pozita pune dhe ka vlerësuar drejt përgjegjësinë që ka marrë para anëtarësisë edhe rezultatet kanë qënë dukshëm të mira.

Unë do të veçoja këtu: SPA Malakastër, Korçë, Pogradec, Devoll, Durrës, Gjiriokastër, Tepelenë, Tiranë Qark, Lezhë, Mat, Bulqizë, Lushnjë, Kuçovë, Peqin, Delvinë etj, drejtuesit e të cilave e kanë vlerësuar drejt qënien në krye të sindikatës, kanë bash-

*Vijon nga faqja 5*

këpunuar edhe me aleaten tonë FSASH dhe, jo vetëm kanë ruajtur strukturat, por, duke punuar së bashku, kanë sh-tuar numrin e anëtarësisë, janë rreguar partnerë seriozë me punëdhënësin dhe kanë mbi 70% të mësuesve të anëtarësuar me kuotë, në sindikatë.

Shqetësimi më i madh gjatë këtij viti për të gjithë ka qënë moszbatimi i ligjit të Arsimit Parauniversitar që ka sjellë konfuzion e veprime arbitrare nga një pjesë e konsiderueshme e drejtuesve të MAS dhe të DAR/ZA, që është shoqëruar, gjithashtu, me paralajmërime e largime nga puna të pabazuara në kontratë dhe në ligj të

këtyre rretheve.

Pa u konsultuar më parë me sindikatat, MAS nxori Urdhërin nr. 363 date 16.09.2014 në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të nenit 148 të Kodit të Punës, Urdhër të cilin SPASH e kundërshtoi me forcë, ashtu sikundër SPASH vlerësoi nxjerrjen e udhëzimit nr.44 datë 16.10.2014, pasi ishte konkretizimi i kërkesave tona ngritur më parë në Komisionin Parlamentar të Edukimit më 28.12.2013 dhe në takimin me Ministren, Znj.Lindita Nikolla më 24 janar 2014, ku ishin edhe përfaqësues të kryesisë së SPASH.

Por konstatojmë që edhe Udhëzimi 44 nuk është vënë në zbatim në të gjitha DAR/ZA, gjë që tregon

plota dhe dokumentacionin e nevojshëm dhe kemi sot në zyrë të dhëna të plota të Vlorës dhe disa rretheve të tjera me më pak probleme, me të cilat do të kërkojmë qëndrimin e të paralajmëruarve për t'u larguar, në vendet e tyre të punës. Meqënëse përmenda këto, do të falenderoja kryetarin e SPA Vlorë z.Ruzhdi Begaj që me punën e tij dhe aleatëve, një javë më parë i detyroi drejtuesit e DAR, duke u vënë në dukje shkeljet ligjore të bëra, të anulojnë urdhërat e nxjerra për 80 anëtarë të aleancës sindikale, të cilët ishin paralajmëruar për ndërprerje të marrëdhënieve të punës. Të njëjtën gjë bënë më parë edhe z.Shaban Duka e z.Sadik Reçi ku u sistemuan në punë të larguarit padrejtësisht nga DAR. Këto raste tregojnë që kur sindikata në bazë punon edhe rezultatet nuk mungojnë.

Ka disa rrethe që kanë 2-3 vite që nuk paguajnë kuotizacionet, SPASH nga ana e vet i ka kryer të gjitha detyrimet ndaj tyre, prandaj në të ardhmen do të zbatohet Statuti.

Në vazhdim, Presidenti i SPASH u ndal në përpjekjet e bëra nga kryesia e aleancës sindikale për shpërblimin e fundvitit nënshkrimin e kontratës së re kolektive të punës të nivelit të parë dhe kundërshtimin e testimit të mësuesve.

Në diskutimet e tyre drejtuesit e SPA të rretheve Gjirokastër, Shkodër, Dibër, Kukës, Elbasan, Vlorë, Lushnje etj. trajtuan shqetësimet me të cilat ndeshen sindikatat e tyre dhe dhanë mendime të ndryshme për zgjidhjen e tyre deri edhe me levizje sindikaliste, si protesta dhe grevë.

Në fund Këshilli Kombëtar, pasi miratoi me votim unanim projektin e zërave të shpenzimeve dhe veprimtarinë e SPASH për vitin 2015, përcaktoi disa nga detyrat e vitit 2015, si forcimi i strukturave, rritja e numrit të anëtarësisë, vjelja e kuotizacioneve, kundërshtimi i testimit të mësuesve, nënshkrimi i kontratës së re kolektive dhe mbrojtja e anëtarësisë dhe interesave të mësuesve, pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme etj.



disa dhjetra mësuesve, midis të cilëve ka edhe drejtues të sindikatës. Më të theksuara këto veprime arrogante të punëdhënëseve të paaftë kanë qënë në rrethet Has, Devoll etj, apo edhe në Kukës e Dibër ku drejtuesve të sindikatës, pas largimit nga detyrat që mbanin në DAR, nuk iu afruan vende pune, ata u punësuan në vende të tjera dhe tani janë në proces gjyqësor. Aktualisht janë të kërcënuar drejtuesit e Devollit dhe Peqinit.

Spash i ka denoncuar veprimet arbitrare të tyre në MAS, por drejtuesit e tyre edhe pas denoncimeve tona nuk kanë reaguar pozitivisht dhe për pasojë edhe partneriteti nuk funksionon, kjo është edhe arsyeja e mos pagimit të kuotave në disa prej

gjendjen e amullisë ku ndodhet MAS, gjendje e cila, bashkë me shkeljet ligjore të manifestuara nga drejtuesit e disa DAR/ZA, po i streson mësuesit.

Për të qënë realistë edhe ne, nuk kemi treguar forcën e e duhur, deri tani ne kemi ndjekur rrugën e zgjidhjes së problemeve me dialog në tavolinën e bisedimeve, kjo e diktuar edhe nga momenti dhe rëndësia që i kemi kushtuar kontratës kolektive, por kjo nuk do të thotë që do të vazhdojmë kështu.

SPASH është e vendosur dhe do të kundërshtojë fort çdo rast largimi të anëtarëve të saj nga puna në mënyrë të kundraligjshme.

Per këtë, u kemi kërkuar të gjithë drejtuesve të strukturave, të dhëna të

# E ardhmja e Profesionit të Mësuesit

*Konkluzione nga Konferenca e ETUCE, mbajtur në Viene, me 26-27 nëntor 2014*

Me rritjen e teknologjisë moderne të komunikimit dhe informacionit (ICT) dhe të internetit, mësimdhënia me anë të librave, dërrasave të zeza dhe shkumësit duket e vjetëruar. Kjo ka influencuar mënyrën si ne 'flasim' me familjarët dhe miqtë, mënyrën si bëjmë pazar, apo si dhe ku punojmë. Në ekonominë tona globale, kalimi më i shpejtë dhe më eficient i shërbimeve të komunikimit u ka mundësuar njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit të lëvizin më shpejt nëpër botë. Mjetet e reja të komunikimit po ndryshojnë mënyrën sesi ne ndërveprojmë me qeveritë, ofruesit e shërbimeve dhe me njëri tjetrin. Këto ndryshime ekonomike dhe sociale kanë transformuar kërkesën për aftësitë që duhet të kenë individët në shekullin e 21-te.

Studentët dhe nxënësit sot, kontrollojnë orarin e tyre online, komunikojnë me miqtë e tyre nëpërmjet rrjeteve të ndryshme sociale dhe u dërgojnë mesazhe me WhatsApp dhe Twitter miqve të tyre në të gjithë botën përpara se të vijnë në klasë. Institucionet arsimore, shkollat etj., pa teknologji moderne mediatike, konsiderohen të vjetëruara në këtë kohë dhe pyetja si do të jetë arsimit dhe profesioni i mësuesit në të ardhmen merr një rëndësi thelbësore. **Ndaj, formësimi i profesionit të mësuesit në shekullin e 21-te është një detyrë e rëndësishme e grupeve të interesit në arsim, dhe vecanërisht sindikatat e arsimit dhe stafet arsimore kanë rol të rëndësishëm në këtë fushë.**

Kongresi i 6<sup>te</sup> i EI në Cape

Town në vitin 2011 nxori në pah në Rezolutën për të Ardhmen e Profesionit të Mësuesit, se arsimit me cilësi të lartë është një e drejtë njerzore themelore për të gjithë nxënësit e studentët, dhe ne zëmë te këtij procesi qëndrojnë mësuesit. [...] *Mësuesit frymëzojnë nxënësit për të përmbushur pritshmerite e tyre.* Dokumenti ynë mbi Arsimin, "Ndërtimi i të Ardhmës përmes Arsimit Cilësor" që, gjithashtu, u adoptua në lidhje me këtë rezolutë, shpjegon më tej që "arsimi është, gjithashtu, një mjet kyç për transformimin, analizimin dhe aplikimin e njohurive dhe eksperiencës, dhe luan një rol qëndror në krijimin e njohurive të reja nëpërmjet kërkimit dhe inovacionit. Roli i tij është më i gjerë sesa roli mekanik dhe instrumental i shumë përbërësve të forcave të tregut dhe modeleve "konsumator – ofrues shërbimi".

Në këtë kontekst, konferenca e ETUCE adoptoi në Budapest në vitin 2012 Rezolutën e Profesionit të Mësuesit, e cila thekson nevojën për të ruajtur dhe rritur nivelin e investimeve publike në arsim në të gjitha nivelet, "për të siguruar që te ketë arsim me cilësi të lartë për të gjithë, si një e drejtë njerzore dhe e mirë publike". Kjo rezolutë, gjithashtu, u kërkon institucioneve dhe qeverive Europiane të "përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies duke zhvilluar një edukim me cilësi të lartë dhe me inovacion për mësuesin dhe duke rritur standardet e mësimdhënies, vecanërisht me anë të zgjerimit të përdorimit pedagogjik të ICT, me ndihmën e mësuesve

të aftë dhe me eksperiencë dhe, gjithashtu, duke përfshirë mësuesit në studime kërkimore rreth cilësisë së mësimdhënies." Për më tepër, rezoluta u kërkon autoriteteve kombëtare t'i konsiderojnë sindikatat e arsimit si partnere të barabarta në procesin e reformimit të sistemit arsimor dhe t'u sigurohet atyre një rol i vazhdueshëm dhe qëndror në vendim-marrjet kombëtare dhe Europiane mbi zhvillimin e politikave arsimore në kuadër të dialogut social dhe negocimit kolektiv në nivel kombëtar dhe Europian.

Duke u bazuar në keto katër shtylla: a) arsimimi si e drejtë njerzore dhe e mirë publike; b) arsimimi cilësor si celësi për krijimin e njohurive dhe risive; c) mësimdhënie cilësore të bazuar në edukim inovativ dhe me cilësi të lartë për mësuesit, përfshirë përdorimin e përmirësuar pedagogjik të ICT dhe d) sindikatat e arsimit si partnere të barabarta në vendim-marrjen kombëtare dhe europiane mbi zhvillimin e politikave arsimore, Sekretariati i ETUCE inkurajon zhvillimin e debatit në të gjitha organizatat e saj anëtare mbi të ardhmen e profesionit të mësuesit. Synimi i debatit është përvijimi i vizionit të sindikatave të arsimit mbi të ardhmen e profesionit të mësuesit, analizimi në mënyrë kritike i sfidave dhe dobësive të këtij profesioni në të ardhmën, dhe për të identifikuar qasje potenciale konkrete për të adresuar këto pyetje me synimin për të garantuar përkthimin e suksesshëm të këtyre vizioneve në praktikë. Cështjet specifike të

*Vijon nga faqja 7*

mbuluara në këtë debat janë

1. Privatizimi i arsimit - *Financimi dhe Partneriteti Publik & Privat në Arsim,*
2. *Inovacioni në Arsim,*
3. *Pabarazia Sociale dhe Profesionit i Mësuesit*

### **1. Financimi i Partneriteteve Publike dhe Private në Arsim**

Pyetja e parë për debatin mbi të ardhmen e profesionit të mësimit ka të bëjë me tendencën në rritje në arsim që po largohet nga financimi publik drejt partneriteve të financuara privatisht. A është në fakt e vetmja rrugë përpara për të siguruar arsimin e të nesërme zëvendësimi i arsimit të financuar me para publike drejt partneriteteve publike private?

**Disa nga sfidat e ardhshme për profesionin e mësimit** që disa qeveri synojnë ti adresojnë me anë të kësaj zhvendosjeje drejt financimit privat të arsimit janë nënvizuar në raportet e studimit të PISA 2012 (Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Studentëve) dhe PIAAC 2013 (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Kompetencave të Rriturve).

#### ***Sfida 1: Mungesë në rritje e mësuesve dhe rënie e pëlqimit për profesionin***

Bazuar në të dhëna të UNESCO-s, rezulton se mësuesit e mirë-kualifikuar janë çelësi për sistemet e suksesshme të arsimit, ndërsa mungesa e tyre dëmton këto procese. Raporti i PISA tregon nevojën për të rritur pëlqyeshmërinë e profesionit të mësimit në të ardhmen si një hap i nevojshëm për arritjen e një klime pozitive të nxënies për fëmijët nga të gjitha prejardhjet

social-ekonomike. Zgjidhja e artë e gjithë këtyre problematikave mund të duket e thjeshtë. Rritja e pagave të stafit arsimor për ta bërë këtë profesion më tërheqës dhe për të mbajtur më shumë mësues, është një zgjidhje që mund t'u ngrohë zemrat disa sindikalistëve ndërsa punëdhënësit e arsimit mbajnë frymën dhe përgatitjen për kundër argumenta të tjera. Raporti i PISA shpjegon se paga e mirë për mësuesit është vetëm një anë e ekuacionit dhe që pagat më të larta, me të vërtetë, mund të ndihmojnë sistemin e shkollave të tërheqin kandidatët më të mirë në profesionin e mësimit. Gjithashtu praktika të tjera mund të detyrojnë ngritjen e politikave për të përmirësuar cilësinë e stafit arsimor duke u shtuar kërkesave për marrjen e një license për mësimit, duke ofruar nxitje për studentët me rezultate të larta që të hyjnë në këtë profesion, ose duke ofruar nxitje për mësuesit për t'u angazhuar në programe të vazhdueshme të zhvillimit profesional. Në tërësi, është e qartë që mund të bëhen kërkesa shtesë për mësuesit për të arritur një shkallë niveli aftësish digjitale dhe për të kryer më shumë detyra sesa bëjnë për momentin.

#### ***Sfida 2: Alokimi i drejtë i burimeve***

Në 10 mesazhet e saj kyce "Cfarë duhet për arsimin cilësor në Europë" ETUCE pretendon: "Alokimi optimal i burimeve si një investim për të ardhmen e Europës është në interes të ekonomisë dhe shoqërisë në Europë" dhe ndaj kërkon që çdo fëmijë, pavarësisht prindërve, pasurisë apo prejardhjes, t'i ofrohet mundësia për arsim me cilësi të lartë. Drejtësia në alokimin e burimeve nuk është e rëndësishme vetëm për barazinë në arsim, por, gjithashtu, ka të bëjë me ecurinë e sistemit arsimor si i tërë. Raporti

i Eurydice Financimi i Arsimit në Europë 2000-2012: Ndikimi i krizës ekonomike (2013) tregon se gjatë periudhës 2000 dhe 2009 shpenzimet për mbështetje financiare për studentët janë rritur gradualisht, "megjithatë nga viti 2010 e në vazhdim, skemat mbështetëse për nxënësit dhe studentët janë kufizuar mjaft në buxhetet e arsimit". Analizat e PISA tregojnë që pabarazia midis studentëve që kanë ndjekur arsimin parashkollor dhe ata që nuk e kanë ndjekur këto nivel arsimi zgjerohet me kalimin e kohës. Është interesante të shihet se, sistemet arsimore me performancë të lartë kanë tendencë t'i alokojnë burimet në mënyrë më të barabartë midis shkollave më të avantazuara dhe atyre të disavantazuara nga ana social-ekonomike. Pyetja që shtohet këtu ka të bëjë me ndikimin e privatizimit të arsimit dhe shpërndarjen e drejtë të burimeve. Nëse hendeku midis nxënësve dhe studentëve të avantazuar dhe të disavantazuar nga ana social-ekonomike po zgjerohet, a është zgjidhja tek financimi i arsimit publik apo mundet privatizimi dhe komercializimi i mjeteve dhe materialeve arsimore të ulë kostot për ta bërë arsimin të aksesueshëm për të gjithë?

#### ***Sfida 3: Globalizimi – Përshtatja me një mjedis pune që ndryshon me shpejtësi***

Inovacioni dhe teknologjia janë faktorët që drejtojnë globalizimin e tregjeve sepse ata rrisin shtrirjen dhe shpejtësinë e komunikimit dhe ndihmojnë në uljen e kostove të prodhimit. Sic vëren dhe OECD, "globalizimi ka patur një ndikim të madh në mundësitë e punësimit dhe në kërkesën për aftësi në tregjet lokale të punës. Në bilanc, tregtia mund të luajë një rol të rëndësishëm në krijimin e punëve më të mira, rritjen

e pagave si në vendet e pasura dhe në ata të varfra, dhe përmirësimin e kushteve të punës”. Megjithatë, globalizimi gjithashtu con në transferrimin e shërbimeve dytesore jashtë sistemit. Punët që kërkojnë aftësi të ulta gjithnjë ë më shumë po zhvendosen nga vendet me pagë të lartë/kosto të lartë në vende me pagë të ulët/kosto të ulta në vendet më pak të zhvilluara. Presioni i konkurrencës dhe ndryshimi teknologjik do të thotë që vendi i punës në këto kohë moderne po ndryshon me shpejtësi. Puna rregullisht riorganizohet ose për të mbështetur hyrjen e teknologjisë ose për të ulur kostot ose për të përmirësuar produktivitetin. Ristrukturimi i punës kontribuon në një ndryshim të kërkesës për aftësi. Ndaj profesionit të mësimdhënies i nevojitet të pregatisë nxënësit dhe studentët për këtë mjedis pune që po ndryshon gjithnjë e më me shumë shpejtësi për t’u mundësuar atyre të përshtaten me shpejtësi me këto struktura të reja dhe të zhvillojnë shpejt aftësi të reja dhe të mbajnë aftësitë e kërkuara. Kjo detyron një lidhje më të ngushtë midis botës së arsimit dhe punësimit, midis universiteteve dhe biznesit, arsimit dhe trainimit profesional dhe kompanive por gjithashtu kërkon adresimin e papunësisë së të rinjëve dhe, në vecanti, përballimin e sfidave që kanë lidhje me kalimin nga shkolla në punë.

#### **Sfida 4: Ndikimi i krizës ekonomike dhe i masave shtrënguese**

Vala e krizës ekonomike të vitit 2008 preku direct ose indirect pothuaj te gjithe vendet e botës, duke goditur ashpër vecanërisht disa shtete Europiane. Për arsye se financat publike në Europe janë nën një presion të jashtëzakonshëm,

qeveritë po kërkojnë mënyra për të ulur deficitet buxhetore dhe për të menaxhuar borxhin public pa kufizuar rritjen e qëndrueshme. Po t’i referohemi raportit “*Arsimimi dhe Trainimi në Europe 2020: Përgjigjet nga Shtetet Anëtare të BE-së*” (2013), publikuar ne Eurydice, na mundesohet per t’u njohur me përpjekejet e bëra nga shtetet anëtare të BE-së për të përmbushur objektivat e Europë 2020 në fushën e arsimit dhe trainimit. Megjithatë sektori i arsimit nuk është imun ndaj masave shtrënguese, vecanërisht në vende ku nevoja për konsolidim fiskal afat shkurtër është e madhe. Sic raporton Eurydice mbi Financimin e Arsimit në Europe 2000 – 2012 rezulton senë 2011 dhe/ose 2012, janë bërë shkurtime në buxhetet e arsimit në njëzet shtete/rajone në Europë. Vec kësaj, kriza ekonomike është parë si një nga arsyet kryesore për bashkimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit. Cereku i vendeve te BE kanë shkurtuar ose shtyrë rinovimet dhe kanë ulur shpenzimet për mirëmbajtje në ndërtesat arsimore si pasojë e krizës, dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, financimi i ICT gjithashtu është ndikuar nga shkurtime në shpenzimet për arsimin.

Në Rezolutën mbi Krizën Financiare dhe Ekonomike, e miratuar nga Konferenca e ETUCE në Budapest në vitin 2012, organizatat anëtare të ETUCE ripohuan që kjo krizë e ka origjinën fillimisht te sektori privat, dhe është e pamoralshme dhe aspak efikase të kërkojnë zgjidhje që nënkuptojnë shkurtime të investimeve në shërbimet dhe infrastrukturën publike. Rezoluta kundërshton hapur masat shtrënguese si një rrugë që nuk ka shanse për sukses për rritje ekonomike të qëndrueshme dhe progress shoqëror në Europë, nese

barra dhe pasojat e krizes do te pake-sojne fondet publike per financimin e arsimit dhe kualifikimin e mesuesve. ETUCE, bazuar ne Rezolutën e EI “Sindikatat kundër politikave neoliberalë dhe planeve shtrënguese në Europë, mbështet kerkesat dhe objektivat per akses të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit publik pa pagesë, per forcimin e strukturave kombëtare të dialogut social, per të drejtat sindikale, kohezionin social, dhe solidaritetin midis brezave.

Megjithatë, duket se, me politikat shtrënguese të përcaktuara nga ideologjitë politike dhe tendencat neoliberalë, arsimi publik (pa pagesë dhe i aksesueshëm për të gjithë) dhe si rrjedhim dhe profesioni i mësimdhënies, vihen nën presion për t’I hapur rrugë në të ardhmen rritjes së privatizimit të shërbimeve fitimprurëse të arsimit. Bie në sy për më tepër se, qeveritë europiane përgjithësisht e konsiderojnë financimin publik të arsimit dhe fondet europiane për infrastrukturën arsimore, per personelin e arsimit dhe trainimin e vazhdueshem te mesuesve, jo si një mjet për të dalë nga kriza dhe si një investim për të ardhmen e Europës, por si një barrë financiare.

Sfidat që qendrojnë përpara sistemeve arsimore në të ardhshmen në Evropë, u trajtuan gjerësisht ne Konferenca nga z. John Mac Beath, profesor i merituar në Fakultetin e Edukimit, Universiteti Cambridge, Britani e Madhe, ne referatin e pergatitur posacerisht me teme: “E ardhmja e profesionit te mësimdhënies”.

Konferenca priti me interesim te vecante diskutimin e z. Xavier Prats-Monné, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Arsimit të Përgjithshëm dhe Kulturës ne

*Vijon nga faqja 9*

Komisionin Evropian, i cili shfaq interesimin e Institucionit qe perfaqeson per te diskutuar rreth këndvështrimit te Komisionit Evropian mbi të Ardhmen e Profesionit të Mësimdhënies me përfaqësues të lartë të sindikatave të arsimit në Konferencën Speciale të ETUCE.

Mirëpresim një diskutim plenar stimulus nga sindikatat e arsimit, nenvizoi ai, mbi sfidat e ardhshme për profesionin e mësimdhënies, kryesisht për sa i përket tendencave të financimit dhe partneriteteve publike e private, për të siguruar arsimin e të nesërmes.

## **2. Inovacioni (risitë) në Arsim – Arsimi i Hapur dhe Profesionit i Mësimdhënies në 2030 – Role të Reja në Mësimdhënie?**

Pyetja e dytë për diskutimin plenar ka të bëjë me faktin si do të jetë edukimi dhe profesioni i mësimdhënies në të ardhmen. Në fund të fundit, debati është rreth rolit që luajnë sindikatat e arsimit botën në ndryshim të arsimit dhe se si dëshirojnë sindikatat e arsimit të pozicionohen në lidhje me ndryshimin e shpejtë dhe kërkues të arsimit. Ky sesion është se si risitë dhe informacionet e reja dhe teknologjia e komunikimit e ndryshojnë arsimin çfarë ndikimi ka ICT mbi mësimdhënien, profesionistët e mësimdhënies, mjedisin e tyre të punës dhe përfaqësuesit e tyre. Skenarët si klasa në 2025 sugjerojnë se roli i shkollave dhe i mësuesve do të ndryshojnë për t'u orientuar më shumë drejt rrjetit social, disa tregojnë se roli i mësuesit është duke ndryshuar nga transferees i dijes në atë të një udhëzuesi për studentët se ku mund të gjejnë material të besueshëm studimi. Disa mësues madje

frikë se teknologjia do të shkurtojë stafin pedagogjik në njëfarë masë në të ardhmen

Në Bashkimin Evropian, Komisioni Evropian po promovon me zjarr përdorimin e ICT në arsim në Evropë dhe ka përshkruar politikën e saj Komunikim mbi Hapjen e Arsimit . Në deklaratën e saj në këtë komunikim, ETUCE ka zbuluar një pasqyrë të gjerë të sfidave të pazgjidhura që Komisioni Evropian, autoritetet kombëtare dhe rajonale të arsimit, stafi i arsimit, sindikatat e arsimit dhe aktorë të tjerë në arsim dhe teknologji duhet të marrin në konsideratë dhe të adresojnë gjatë zbatimit të përdorimit pedagogjik të ICT në arsim dhe trajnim. Disa nga këto janë adresuar këtu:

### ***Sfida 5: Rritje e mëtejshme e aksesit në kompjutera, ICT dhe internet.***

Nuk ka asnjë dyshim që aksesit në internet dhe përdorimi i kompjuterave si në shtëpi dhe në punë tani është e përhapur në vendet e OECD (PIACC). Ndërmjet viteve 1999 dhe 2009, numri i abonimeve të internetit në vendet e OECD është gati trefishuar, dhe numri i abonimeve të telefonisë mobile më shumë se trefishuar. Në mbi dy të tretat e vendeve të OECD-së, mbi 70% e ekonomive familjare kanë akses në kompjuter dhe internet në shtëpitë e tyre. Hyrje në internet është gjithashtu i përhapur në vendin e punës. Në shumicën e vendeve të OECD-së, punëtorët në mbi 95% të bizneseve të mëdha dhe ato në mbi 85% të bizneseve të mesme të kenë akses dhe përdorin internetin si pjesë e punës së tyre, dhe punëtorët në të paktën 65% të bizneseve të vogla lidhen në Internet për punë. Kjo dëshmon se aftësitë digjitale janë një kusht paraprak për

shumë punësime, megjithatë ende përmirësimi i kompetenca digjitale në arsimimin e të rriturve dhe të të nxëniet gjatë gjithë jetës nuk po marrin vëmendje të mjaftueshme. Për më tepër, këto tendenca nuk janë pasqyruar në mënyrë të duhur në sektorin e arsimit. Sondazhet e fundit tregojnë, numri i kompjuterëve për nxënës në shkollat e mesme është në rritje dhe sigurohen gjithnjë e më shumë laptopë dhe dërrasa të bardha, megjithatë, ka akoma ndryshime të gjera mes vendeve të ndryshme. Ka edhe ndryshime të mëdha në shkallën e përdorimit të pajisjeve të ITC në institucionet e arsimit në Europë. Për më tepër, ka një mos-përputhje në rritje midis nivelit të ofrimit të kompjuterit në shkolla dhe frekuencën e përdorimit të ITC nga ana e studentëve. Ndaj sindikatat e arsimit, duhet të pyesin veten se si mund të forcojnë ndikimin e tyre për të rritur qaksesin në kompjuter, dhe internet në institucionet arsimore për stafin dhe studentët në mënyrë që të fusin si praktikë të zakonshme mësimdhënies innovative me anë të përdorimit të ICT.

### ***Sfida 6: ICT-të po ndryshojnë mënyrën sesi ofrohen dhe konsumohen shërbimet***

Kompjuterat dhe ITC po ndryshojnë mënyrat në të cilat shërbimet publike dhe shërbimet e tjera ofrohen dhe konsumohen. Njohja dhe përdorimi i ITC është bërë pothuajse një parakusht për të aksesuar shërbimet themelore publike dhe për të ushtruar të drejtat dhe detyrimet si qytetarë. Shumë qeveri po i japin shërbimet publike, përfshirë tatimet, shëndetësinë dhe shërbimet e tjera të mirëqenies sociale, nëpërmjet internetit dhe kjo tendencë ka të ngjarë të vazhdojë. Përqindja e qytetarëve

dhe bizneseve që përdorin internetin për të bashkëvepruar me autoritetet publike u rrit me shpejtësi në shumë vende të OECD në mes 2005 dhe 2010: mesatarisht 40% e qytetarëve dhe 80% e bizneseve në vendet e OECD ndërvepronin me autoritetet publike nëpërmjet Internetit në vitin 2010. Kjo dëshmon të jetë një sfidë e madhe për sektorin e arsimit, sepse përdorimi i ICT në arsim është vetëm në fillimet e saj: ai është përdorur kryesisht për qëllime thjesht administrative në institucionet e arsimit dhe në një masë më të vogël nga ana e stafit për organizimin e klasës dhe shumë më pak akoma për përdorime pedagogjike dhe përgatitjen e studentëve për përgjegjësitë e qytetarisë moderne demokratike. Pyetja është, janë institucionet e arsimit mirë të këshilluar që të injorojnë ose të përjashtojë zhvillimin e shpejtë të teknologjisë moderne nga pedagogjia dhe të vazhdojnë mësimdhënien në një mënyrë tradicionale?

***Sfida 7: Promovimi i arsimit të hapur dhe aplikimi dixhital si një mjet që sjell vlerë të shtuar në mësimdhënien dhe mesimnxënien***

Në rekomandimet e projektit ELFE 2 (Formimi eLearning për Arsimin), ETUCE thekson sesa e rëndësishme është që secili institucion arsimor të ketë vizionin e tij për përdorimin pedagogjik të ICT dhe si të promovojë objektivat dhe aftësitë e shekullit të 21<sup>te</sup>, kompetencat kyce për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Në të njëjtën linjë argumenti, ETUCE mbështet në deklaratën e saj mbi *Hapjen e Arsimit*, që risitë në arsim bazuar në trainim në përdorimin e teknologjive digjitale, mund të zgjerojnë aksesin në arsim dhe mund të kontribuojnë në zgjid-

hjen e cështjes serioze të rritjes së papunësisë, që vjen si rezultat i recensionit aktual ekonomik në gjithë BE-në. ETUCE gjithashtu nënvizon se industria e web-it po gjeneron rritje ekonomike më shumë nga prespektiva ekonomike dhe konsiderohet më pak si një e drejtë njerzore dhe një parakusht i nevojshëm për të nxënëit gjatë gjithë jetës. Kjo është e qartë dhe në një raport të vitit 2014 nga Qendra e Përbashkët Kërkimore Europiane me temë: *Planimetria dhe analizimi i teknologjive të ardhshme për nxënien. Rezultatet nga një konsultim me grupet Europiane të interesit dhe udhërrëfytyesit për politikë veprimin, raport* që ofron një prespektivë Europiane mbi teknologjitë dhe të nxënëit në tre fusha të nxënies: arsimi dhe trainimi formal; nxënia në vendin e punës dhe në lidhje me punën; strategjitë e riaftësisimit dhe rritjes së aftësive për punonjësit. Si një studim tregu, raporti ve theksin mbi përdorimin aktual dhe të mundshëm të teknologjive në arsim dhe orienton në strategji dhe veprime për një zhvillim efikas të teknologjive në procesin e nxënies.

Si rrjedhim, kerkohet që roli i sindikatave të arsimit të jetë ndikimi mbi masen e sindikalisteve dhe mesuesve për krijimin e opinionit mbi domosdoshmerise e nevojës se inovacionit të thellë dhe ICT-së në arsim dhe të tregojnë sesa thelbesore janë këta për studentët, stafin arsimor dhe qytetarët në përgjithësi pasi prekin cdo aspekt të jetës së tyre?

***Sfida 8: Të Nxënëit dhe Mësimdhënien pavarësisht hapsirës dhe kohës – burimet e arsimit të hapur***

Tendenca për burime arsimi të hapur, vecanërisht Kurse Masive Online (MOOCs) tregon se ka një tërheqje të madhe nga ana e njerëzve për të mësuar dhe studiuar

cdo gjë në cdo kohë dhe pa kufizime kohore. Studentët mund të shkarkojnë nga interneti mësimet e tyre, të studiojnë pa qenë fizikisht prezentë në një ndërtesë arsimore. Kjo ka ndikime të shumta si në nxënie dhe në mësimdhënien, përfshirë miratimin dhe vlerësimin e studimeve, cilësinë e arsimit, disponueshmërinë e stafit mësimor, individualizimin e lartë të studimeve për sa i përket zgjedhjes së lëndëve, temave dhe ngarkesës mësimore, kostos së arsimit, ofruesit e arsimit, ndryshimin e rolit të mësuesit, etj.

Burimet e arsimit të hapur në mënyrë të qartë përfaqësojnë një epokë të re të arsimit dhe kjo përsëri është e lidhur me kapitullin e mëparshëm që trajtonte privatizimin e arsimit. Edukimi bëhet një model biznesi dhe sic thekson Qendra e Përbashkët Kërkimore këto modele të reja të biznesit nuk kanë qëndrueshmëri dhe të paktën në arsimin e lartë janë “ende kryesisht të varura nga financimi institucional, filantrop ose qeveritar/ publik”.

Sindikatat e arsimit duhet të vlerësojnë me kujdes këtë prirje për të gjetur avantazhet dhe disavantazhet reale të teknologjisë për të asistuar mësimdhënien. Në veçanti, hapa fillestare janë duke u ndërmarrë në formën e projekteve pilot në fillore, shkollat e mesme dhe në shkollat e arsimit profesional për të aplikuar këtë model arsimor biznesi në sektorë të tjerë të arsimit. Edhe pse mund të argumentohet se pjesëmarrja sociale është thelbesore për zhvillimin e suksesshëm të nismave të ICT në arsim, përfshirja aktive e sektorit privat dhe komuniteteve lokale duhet të shihet si kritike. Sindikatat e arsimit duhet të mbeten vigjilente në lidhje me lirinë akademike të personelit

*Vijon nga faqja 11*

arsimor, veçanërisht, në dritën e rritjes së shqetësimit në lidhje me de-profesionalizimin e profesionit të mësimdhënies, si dhe ndikimin në rritje të shoqërive tregtare mbi diktimin e kurrikulave, përmes ICT dhe aplikacioneve të tjera të internetit në arsim.

### **3. Modeli Social European nën Sforcim – Pabarazitë Sociale dhe Profesionit të Mësimdhënies, Kriza Ekonomike dhe Pabarazitë Sociale – A do jetë Arsimit përsëri Zgjidhja?**

Sesioni i tretë i fton delegatët në Konferencën e Posaçme të ETUCE për të diskutuar rritjen e pabarazive në shoqëri dhe në arsim për shkak të disavantazheve të vazhdueshme sociale. Cili është reagimi i sindikatës së arsimit për të luftuar në të ardhmen ndikimin e pabarazive sociale? Arsimit është konsideruar gjithmonë zgjidhja për të niveluar ose për të korrigjuar padrejtësinë dhe disavantazhet sociale, dhe si i tillë, zgjidhja më e mirë për të nxitur rritjen ekonomike. Pyetja këtu është: në kohën kur globalizimi është drejtuesi i tregjeve të konkurruesës së ashpër dhe kur vendet janë duke luftuar për të shmangur ndikimin e krizës ekonomike dhe financiare, a do të vazhdojnë sistemet e arsimit dhe profesionit të mësimdhënies të kenë manovrim të mjaftueshëm për të siguruar arsim cilësor dhe nxënie gjatë gjithë jetës si parakushte për rritje ekonomike?

Disa nga sfidat kryesore për të cilat duhet të përgatiten sindikatat e arsimit janë nënvizuar më poshtë.

Që nga krijimi i Modelit Social Evropian në prag të Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi European ka sjellë paqe dhe progres ekonomik dhe social. BE me 28 Shtetet

Anëtare të tij, është një sistem unik përse I perket vendimmarrjes dhe bashkëpunimit. Objektivat themelore sociale, të tilla si promovimi i punësimit, përmirësimi i jetesës dhe kushteve të punës, mbrojtja e duhur sociale, dialogu social, zhvillimi i fuqisë punëtore për punësim të qëndrueshëm dhe të lartë dhe lufta kundër përjashtimit janë të përcaktuara në Traktatin themelues të Komunitetit Evropian. Karta e BE-së për të Drejtat Themelore të Njeriut përmban kapituj mbi lirinë, barazinë dhe solidaritetin, artikulon të drejtat për kushte të duhura të punës, sigurim social dhe ndihmën sociale, barazinë midis burrave dhe grave, dhe të drejtat e sindikatave si marrëveshjet kolektive dhe grevat. Parimet qendrore janë solidariteti dhe kohezioni: rritja ekonomike duhet të shërbejë për të rritur mirëqenien e përgjithshme shoqërore, dhe jo të disavantazhojë ndonjë pjesë të shoqërisë.

#### ***Sfida 9: Ruajtja dhe Promovimi i Strukturave të Dialogut Social***

Themeluar mbi parimin se standardet e larta shoqërore janë të dobishme për ecurinë ekonomike, është e qartë se dialogu social nxit inovacionin dhe rritjen ekonomike, sepse ai përmirëson moralin e punonjësve dhe i jep punonjësit më shumë kontroll mbi detyrat që kryen. Kështu dialogu në mes të partnerëve sociale, informimi dhe konsultimi midis drejtuesve dhe të punësuarve janë aspekte të rëndësishme të Modelit Social Evropian. Të drejtat e puntorëve ndihmojnë në krijimin e një fuqie puntore të aftë dhe inovative. Megjithatë, sic përshkruan ILO në deklaratën e saj *Pse është akoma i përshtatshëm Modeli Social*

*European*, politikat e konsolidimit fiskal të krizës ekonomike e sociale kanë cuar në ndryshime të mëdha. Në shumë vende, reformat e tregut të punës u përshpejtuan, duke rritur fleksibilitetin dhe reduktimin e sigurisë së punës. Reformat e pensioneve kufizojë rritjen e shpenzimeve në sistemin e pensioneve dhe nivelet relative të pensionit pritet të bien në mënyrë dramatike në të ardhmen. Shkurtime në shpenzimet publike kanë ndikuar në cilësinë dhe qëllimin e shërbimeve publike në shumë vende. Përveç kësaj, efektiviteti i politikave në disa vende që kanë për qëllim rritjen e aftësisë konkurruese duke ulur kostot e punës janë me të vërtetë të diskutueshme. Veçanërisht në të ashtuquajturat vende me deficit janë të dukshme ndryshimet e rëndësishme në mbulimin dhe qëllimin e bisedimeve kolektive. Në rezolutën mbi Përvijimin e të Ardhmes së Profesionit të Mësimdhënies, ETUCE mbështet synimin që “të gjithë mësuesit të marrin pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë, të marrin rroga dhe skema pensioni të denja, si dhe kushte të duhura të sigurisë dhe shëndetit në punë, ekuivalente me standartet në profesione të tjera që kërkojnë të njëjtin nivel kualifikimsh”.

#### ***Sfida 10: Minimalizimi i Pabarazisë Digjitale dhe mbështetja e një shoqërie informacioni gjithëpërfshirës***

Sfida e konkurrueshmërisë në Europë, në vecanti në Europën Jugore, nuk është më pak e lidhur me mbylljen e hendekut teknologjik. Në fakt, lufta kundër pabarazive dixhitale është shqetësim për të gjithë Europën. Ka të dhëna të një

polarizimi midis këtyre vendeve që ia dalin të promovojnë një shoqëri përfshirëse informacioni dhe atyre që nuk ia dalin. Përvec pabarazive ekonomike, sociale dhe organizative, Europa përballet me një disavantazh të thellë ndarjesh digjitale. Kjo ndarje përkufizohet si 'hendeku midis individëve, familjeve, bizneseve, dhe fushave gjeografike në nivele të ndryshme social-ekonomike për sa i përket si mundësive të tyre për të aksesuar ICT-të dhe përdorimit të Internetit nga ana e tyre për një llojshmëri aktivitësh të ndryshme'. Hulumtimet tregojnë se shpërndarja e mëparshme krahasimisht e barabartë e pabarazisë është zhvendosur drejt te pasurit më shumë barazi dhe rëndimit të përcaktimit social të përdorimit të ICT në shtetet anëtare që kanë mbetur prapa. Adresimi i hendekut digjital kërkon një qasje me shumë aspekte sepse ajo pasqyron pabarazitë e shoqërisë. Ai përfshin gjithashtu fusha të tilla si: infrastruktura e rrjetit, kostoja e ICT, arsimit, të ardhurat, moshën, gjinia, dhe përdorimi i ICT, mbështetja e qeverisë në lidhje me promovimin e përdorimit të teknologjisë (nëpërmjet investimeve dhe financimeve), aksesit, gjuha, vendndodhja, dhe përkatësia etnike. Studimet tregojnë qartë se sa më i lartë te jete **niveli i arsimit**, ka më shumë të ngjarë që një person të ketë akses dhe të përdorë ICT. Një faktor tjetër janë **të ardhurat**, sepse ilustron shkallën në të cilën një përdorues mund të përballojë koston e aksesit në Internet. **Mosha** e përdoruesve potencialë të ICT ka ndikim të konsiderueshëm në aksesimin dhe përdorimin e ICT-ve. Në përgjithësi, aksesit në internet dhe përdorimi i kompjuterave personal kanë tendencë të jenë tre herë më të lartë tek të rinjtë (16-24

vjeç) sesa tek njerëzit e moshuar (55-74 vjeç). Këto çështje duhet të adresohen kur miratohen politikat e ICT-ve si në nivel institucionesh kombëtare edhe atyre të arsimit, për të shmangur pabarazitë ekzistuese që janë duke u përkeqësuar. Kjo tregon se, përvec zhvillimit të mëtejshëm të infrastructures së rrjetit, Europa duhet të investojë shumë në sisteme më efektive dhe efikase të arsimit dhe trajnimit. Iniciativat ICT në institucionet arsimore duhet të shoqërohen me programe të shëndosha edukimi dhe trajnimi në detyre dhe para fillimit të detyrës për mësuesit. Stafit arsimor duhet të ndjehet rehat në përdorimin e teknologjisë dhe të mbështetet në përdorimin e aplikacioneve të reja në mënyrë që ta përdorin ICT në mënyrë të përshtatshme. ICT-ja u ofron studentëve aftësi të ndryshme të të mësuarit dhe krijon mundësi për të ndjekur programe të individualizuara edukative që fokusohen tek nevojat e tyre të veçanta.

Është e qartë se arsimit nuk mund t'i zgjidhë problemet e pabarazisë sociale në vetvete. Gjithashtu është e dukshme se pa akses të barabartë dhe nxenie cilësore për të gjithë, mangësitë ekzistuese me siguri do të thellohen. Reforma arsimore ka fituar një shtytje të re nga mundësitë që ITC dhe shoqëria e njohurive sjellin tek kauza e të mësuarit, e barazisë dhe transformimit shoqëror. Teknologjitë e reja përbëjnë një mjet jashtëzakonisht të fuqishëm për të zgjeruar aksesin dhe për të përputhur kërkesën sociale në rritje për arsim më të larmishëm dhe të posaçëm gjatë gjithë jetës. Europa duhet të përqendrohet në promovimin e mëtejshëm të një ekonomie të bazuar në dije dhe aftësi të larta. Kjo mund të arrihet vetëm duke

investuar në kërkime shkencore dhe inovacion, duke krijuar më shumë vende pune më kualitetit të lartë, dhe për të bere te mundur që punëtorët të kenë aftësitë për ti përmbushur këto detyra. Në 2002, partnerët socialë europianë ranë dakord për një kuadër të veprimeve për zhvillimin e të nxënës gjatë gjithë jetës. Me synimin për të vazhduar këtë vrull dhe me qëllim që profesioni i mësimit të ndihmojë për të ngushtuar hendekun digjital dhe për të luftuar pabarazitë digjitale në të ardhmen. Problemi është : si parashikojnë sot sindikatat e arsimit në Europë të kontribuojnë në ofrimin e mundësive arsimore që vihen në dispozicion përmes ICT si një mjet i fuqishëm për tejkalimin e pabarazisë sociale?

### ***Sfida 11: Ulja e pabarazisë sociale nëpërmjet edukimit, pavarësisht krizës ekonomike***

Në kohën kur qeveritë po kërkojnë të ulin borxhet, shpenzimet publike janë ulur në të gjitha fushat, pa marrë shumë në konsideratë qëllimet e shumicës së vendeve para krizës, që do të thotë për të siguruar kohezionin rajonal dhe social. Rritja e papunësisë dhe problemet sociale kanë çuar sërish në rritje të nacionalizmit, përjashtimit shoqëror, stereotipeve gjinore dhe stigmatizimit të disa grupeve,, siç janë romët. Shkalla e varfërisë dhe përjashtimit janë rritur në mënyrë alarmuese dhe shtrihen në një pjesë të madhe të klasës së mesme. Politikat e qeverive për të rritur normat e punësimit kanë treguar pak efekt, dhe arritjet në punësimin e të rinjve janë përgjithësisht zhgënjyese. Shkurtimeve të përgjithshme në arsim dhe në politikën sociale nuk po e zbusin këtë tendencë afatgjatë dhe as problemin më të përgjithshëm

*Vijon nga faqja 13*

të një përqindje të rritur të atyre që paguhen pak dhe të punëtorëve të varfër, që po krijon më shumë dobësi dhe tek ata që janë të punësuar. Monitorimi i Ecurisë së Mbrojtjes Sociale të BE-së thekson se situata sociale në Bashkimin Evropian nuk është duke u përmirësuar, ndërsa në disa vende situata është duke u përkeqësuar.

Të dhënat PIAAC tregojnë se emigrantët që vijnë nga vende që përdorin gjuhë tjetër, kanë aftësi në mënyrë të konsiderueshme më të ulët në shkrim-lexim dhe numërim se sa të rriturit amtare. Problemi rëndohet për emigrantët që flasin gjuhë të huaj, të cilët vijnë nga prejardhje të pafavorizuara ekonomiko - sociale. Kur Niveli i ulët arsimor kombinohet me aftësi të dobët në gjuhën e vendit pritës, integrimi në shoqëri bëhet i vështirë. Një tjetër pasojë e pabarazive socio-ekonomike dhe dallimeve demografike, të tilla si mosha apo gjinia, është se ato shpesh shoqërohen nga ekspozim te pabarabartë ndaj faktorëve të rrezikut të mjedisit. Prandaj pabarazitë social-ekonomike çojnë në pabarazi shëndetësore dhe shumë shpesh i vënë grupet e pafavorizuara në rrezik në mënyrë të konsiderueshme më të lartë ndaj efekteve shëndetësore të mjedisit.

Në kontekstin e arsimit, po shfaqen raportet e fundit kërkimore të bashkimeve të fundit dhe mblylljeve të shkollave, zvogëlimin e buxheteve për infrastrukturën arsimore dhe për programe të veçanta të mbështetjes arsimore dhe tendenca në rënie në financimet, si dhe ndryshime në politikat kombëtare për mbështetjen financiare të nxenesve dhe studentëve. Kjo po ndodh edhe pse dihet se buxheti i ndarë për një mbështetje të tillë është një

nga elementet kyç në sigurimin e niveleve të larta të pjesëmarrjes në arsim, veçanërisht për grupet e pafavorizuara të studentëve. Fëmijët hyjnë në arsim nga prejardhje të ndryshme, kanë eksperiencë të ndryshme në edukim, dhe largohen nga shkolla me rezultate mjaft të ndryshme. Fëmijët nga familje më të varfra dhe më të disavantazuara kanë shumë gjasë të ndjekin shkolla me performancë të ulët dhe të arrijnë rezultate të ulta akademike. Institucionet arsimore përballen me sfidën e gjetjes së mënyrave për të thyer zinxhirin e disavantazhit, dështimit arsimor dhe shanseve të kufizuara në jetë.

Është e qartë se politikat duhet të përqëndrohen për të bere te mundur qe përmirësimi i situatës sociale në të gjithë Evropën të bëhet gjerësisht prioritet i përbashkët. Reformat strukturore duhet të marrin në konsideratë shqetësimet sociale dhe ato të punësimit. Reformat duhet të jetë të vlerësuara përsa i përket ndikimit që kanë dhe të renditen për të minimizuar efektet negative. Ku reformat sjellin kompromise, ato qe jane në rrezik më të madh varfërie dhe përjashtimi social nuk duhet të mbajnë barrën e përshtatjes ekonomike. Udhëheqësit evropianë duhet të investojë në politika të përpiluara për të zvogëluar efektin e pabarazisë, edhe pse duan shumë vite për ti treguar rezultatet pozitive. Ata kanë nevojë për të kapërcyer hezitimin e tyre për reforma të tilla për shkak se rezultatet janë rrallë të dukshme brenda cikleve zgjedhore ose për shkak se rishpërndarja për të luftuar efektet e varfërisë nuk është popullore tek votuesit. Investimet progresive në shërbime shëndetësore, arsimim dhe shërbimet mbështetëse familjare për fëmijët dhe familjet duhet të

ecin krah për krah njëra tjetrës. Organizata Botërore e Shëndetësisë sinjalizon qartë nevojën për të bere te mundur që investimit për fëmijët më të vegjël t'i jepet prioritet i lartë dhe i duhur. Megjithatë, edhe pse pretendohet se ekonomia po e merr veten, trashëgimia e krizës në aspektin social dhe buxhetor, rreziku i një rritje të vazhdueshme të ulët ekonomike për disa vite, dhe sfida e plakjes së popullsisë, e bën synimin e progresit ekonomik dhe kohezionin social edhe më sfidues.

Pyetja është: cfarë roli duhet të luajnë sindikatat e arsimit në këtë fushë të politikave në të ardhmen. Si mund të kontribuojë profesioni i mësimdhënies për të siguruar arsim cilësor për të gjithë në të ardhmen? A munden sindikatat e arsimit dhe profesioni i mësimdhënies në përgjithësi ta ngushtojnë hendekun e pabarazisë sociale? Roli i sindikatave të arsimit duhet të jetë me siguri më shumë sesa mbledhja e copave të thyera të qelqit dhe mbështetje e rimëkëmbjes nga kriza duke zbutur rrugën për rimëkëmbjen ekonomike.

Vazhdimi i diskutimit për te ardhmen e profesionit te mesuesit duhet ta beje me te qarte lidhjen midis krizës ekonomike dhe pabarazive shoqërore. Dikutimi gjithashtu duhet te perpiqet t'i jape pergjigje pyetjes nëse arsimi eshte akoma zgjidhje për rritjen ekonomike në të ardhmen, sic ka qene kredoja e qeverive Europiane dhe besimi per progres nepermjet arsimimit cilesor, pas sistemeve arsimore në shekujt e kaluar. Gjithashtu diskutimi i ketij problemi kyc, nepermjet nje debati te gjalle, bazuar ne modelin social European, duhet te synoje te perballoje trysninë që ushtron pabarazia shoqërore mbi te ardhmen e profesionit te mësimdhënies.

## Nga Fjala e Sekretarit të Përgjithshëm të EI, Fred van Leeuwen, ne Konferencën e ETUCE mbi te ardhmen e profesionit të mesuesit

E ardhmja e profesionit të mesimdhënies është, pa dyshim, e lidhur direkt me të ardhën e sistemit tonë arsimor. Rreth njëzet vjet më parë, Presidenti i Komisionit Europian të asaj kohe, Jacques Delors, paraqiti raportin novator të UNESCO-s – “**Edukimi: Thesari në brendësi**”, i cili hodhi dritë në të ardhmen e edukimit në shekullin e 21-të. Akoma konsiderohet aq i rëndësishëm sot sa ishte në vitin 1996.

Raporti bazohet në katër shtylla: **Edukimi për të Ditur; Edukimi për të Vepruar; Edukimi për të Qenë; dhe Edukimi për të Jetuar së Bashku**. Këto katër shtylla ishin përpiluar si një bazë për edukimin e suksesshëm në atë që raporti i referohej si “një botë që po ndryshonte me shpejtësi”. Pra, ne po e jetojmë atë botë sot. Kur shikoj këto katër shtylla, kam frikë se ne jemi shumë prapa në dy prej tyre.

Për gjithcka që edukimi na mëson, se si të dimë dhe si të veprojmë – aftësitë praktike që na ndihmojnë të orientojemi në jetë – gjithashtu ka rëndësinë e madhe për të shpërndarë vlerat demokratike mbi të cilat bazohen kulturat dhe shoqëritë tona. Dhe kam frikë se kur shikoj c’ndodh në Lindjen e Mesme, dhe c’po ndodh në Europë, pabarazinë në rritje, ekstremizmin e djathtë që përsëri po ngre kokën e tij të shëmtuar, përhapjen e ksenofobisë, racizmin, anti-semitizmin, islamofobinë, homofobinë nëpër rajone, kur i shikoj të gjitha këto, me duket që dy nga katër shtyllat e Jacques Delors, **Edukimi për të Qenë, dhe Edukimi për të Jetuar së Bashku**, të cilat ndihmojnë në krijimin e identitetit, tolerancës dhe kohezionit, kanë nevojë serioze për t’u mirëmbajtur.

Ne perballemi me rrezikun që te kater shtyllat, të cilat synojnë një qasje arsimimi për të gjithë dhe të mesuarit gjatë gjithë jetes, të dobsohen dhe të deklarohen trashëgimi të UNESCO-s, nderkohe që profesioni i mesimdhënies, vazhdon të humbasë forcen, besimin dhe pelqyeshmerinë.

Në Europë dhe në botë, më përjashtime të dukshme, mesuesit gjithnjë e më shumë po punojnë me kontrata të përkohshme, ngarkesa e tyre e punës po rritet, hapsira e tyre personale po ngushtohet, autonomia e

tyre po sfidohet, aksesit në zhvillimin profesional po kufizohet, ata shpesh marrin paga që janë poshtë pagës mesatare, dhe madje në disa vende u mungojnë kualifikimet, aftësitë, mbështetja dhe materialet mësimore për të dhënë mësim dhe për ta bërë mirë këtë punë. Gjenerata aktuale e mesuesve po moshohet dhe një numër alarmues mesuesish të rinj po e lënë profesionin brenda viteve të para të punësimit. Ne e quajmë këtë de-professionalizim.

Prej muajsh tashmë, në kemi studiuar mesuesit në 123 shtete për kushtet e tyre të punës. Më lini të ndaj me ju atë c’ka thanë ata:

- Rreth 60% mendojnë se nuk konsultohen fare rreth masave të marra nga autoritetet publike për reformimin e arsimit. Edhe nëse konsultohen, 30% thonë që pikëpamjet e tyre injorohen plotësisht
- 68% thonë që ngarkesa e tyre e punës vazhdon të rritet
- 50% thonë që paga e tyre mjafton vetëm për të mbuluar nevojat e tyre bazë, ndërsa
- 20% thonë që u duhet të gjejnë një punë të dytë për të mbyllur muajin
- Së fundmi, 45% duan ta lënë profesionin.

Shifra dëshpëruese. Në mars ne do të paraqesim këto të dhëna në Samitin e Katërt Ndërkombëtar mbi Profesionin e Mësimdhënies, ku Ministrat e Arsimit nga 25 shtete dhe lidere të sindikatave tona të arsimit në këto vende do të diskutojnë rreth temës “Lidershipi i Mësuesve”. Mesazhi ynë është i qartë. Nëse qeveritë e marrin seriozisht çështjen e përmirësimit të arsimit, atëherë ata duhet të fillojnë të dëgjojnë mesuesit. Mësuesit, si aktorë në procesin e edukimit, profesionistë të kualifikuar dhe me eksperiencë, i dinë kush janë nevojat e studentëve për t’ia dalë mbanë. Ata kanë eksperiencë dhe kompetencë profesionale për të kontribuar në zhvillimin e politikave të arsimit, në kurrikulat dhe metodologjitë e mesimdhënies.

Të dëgjosh mesuesit do të thotë të dëgjosh mësuesin e klasës, lektorin, në vendin e tij të punës, po gjithashtu do të thotë të dëgjosh përfaqësuesit e tyre, sindikatat e

arsimit, në të gjitha nivelet ku zhvillohen politikat e arsimit. Të dëgjohemi jo vetëm kur mblihdemi në Samite Ndërkombëtare por dhe në vendet tona respektive. Në shumë vende, edhe në vendet ku të drejtat e negociatave kolektive respektohen plotësisht, nuk egziston një dialog kuptimplotë mbi të ardhmen e profesionit të mesimdhënies. Ka disa shembuj shqetësues të një mospërfillje të plotë të ekspertizës profesionale që ne, bashkërisht përfaqësojmë. De-professionalizmi nuk është çështje vetëm që mesuesit e shkollave nuk dëgjojnë dhe u hiqen përgjegjësi të rëndësishme profesionale; por po shfaqet edhe në faktin që në mjaft raste sindikatat e arsimit po injorohen si mbrojtëset dhe përfaqësueset e profesionit të mesimdhënies.

U gëzova kur dëgjova ministrin e ri Suedez të arsimit dy javë më parë që fliste në kongresin e Lararforbundet në Stockholm. Ai tha që dëshironte të ndihmonte në rindërtimin dhe forcimin e profesionit të mesimdhënies dhe t’i mbante politikanët jashtë klasës së mësimit. “Nuk do t’u mësoj mësuesve si të japin mësim,” dëgjova që thoshte, “ashtu sic nuk do doja të dëgjoja kolegun tim ministër të shëndetësisë t’u diktonte profesionistëve të mjeksisë si të diagnostifikonin pacientët e tyre dhe çfarë medikamentesh tu jepnin”.

A është ai një zog i rrallë, si korbi i bardhë i veriut? Shpresoj që jo, sepse ne vërtet do të pushojmë së qeni një profesion që në momentin që do t’ua lëmë fatin e profesionit të mesimdhënies vetëm qeverive, politikanëve dhe të tjerëve të vendosin standarde dhe të vendosnin të ardhmen e profesionit tonë.

Kjo, kolegë, është një nga dy sfidat kryesore që gjenden para nesh: të kundërshtojmë de-professionalizmin dhe rimarrja e kontrollit para se ta shkatërrojmë të tjerët.

Sfida tjetër është gjithashtu e njohur. Në të gjithë Europën, dhe në botë, në po shohim një valë politikash konservatore. Politika që po vë në shenjestër shërbimet publike, dhe arsimit është në shenjestër direkte. Masat shtrënguese po trumbetohen

*Vijon nga faqja 15*

si zgjidhje e problemeve fiskale ekonomike – Rimëkëmbja e mrekullueshme, na thonë ne, duhet të vijë nga sektori privat.

Ne nuk jemi dakort. Ne besojmë në rolin e Shtetit për të siguruar barazinë, ne besojmë në shërbime publike cilësore, në besojmë që arsimit është një e mirë publike dhe e drejtë njerëzore; që cilësia e lartë, standartet e larta profesionale dhe sindikatat e forta profesionale shkojnë krahas për krahas. Lufta jonë për arsim cilësor nuk përfundon tek kufiri i vendit tonë, por është një luftë që zhvillohet në nivel evropian dhe global. Ndaj ne jemi të gjithë në vijën e frontit.

Kur një sistem arsimor është i dobët, shkollat janë të financuar shumë pak, dhe kur mësuesve u merret qëndrimi profesional, grabiqarët e tregut dhe privatizimit fillojnë të vërtiten, duke pritur momentin e duhur për të sulmuar. Ne nuk mund ta lejojmë këtë.

Kolegë, në duhet të kemi besim tek vetja. Dhe duhet të mobilizohemi. Ne duhet të organizohemi. Pushteti i njerëzve funksionon. Një numër i madh njerëzish nuk mund të injorohen. Bashkimi ynë për fushatën e Arsimit Cilësor e ka demonstruar këtë tashmë. Dhe më lini t'ju falenderoj të

gjithëve për angazhimin dhe përkushtimin.

Qëkur nisëm fushatën në Tetor të vitit 2013, 109 sindikata në 74 shtete, që përfaqësojnë rreth 40% të anëtarësisë sonë, organizuan 318 raste ku mobilizuan anëtarët e tyre. Dhe që nga dita e parë mesazhi ynë ka qenë i qartë dhe i thjeshtë: Ne duam që shkollat tona, që nga institucionet e fëmijërisë së hershme, deri tek kolegjet dhe universitetet të jenë të aksesueshme për të gjithë. Ne duam mësimdhënie cilësore, mjete cilësore dhe mjedise të sigurta dhe të shëndetshme edukimi. Dhe mesazhi më në fund po depërton!

Një vit më parë Kombet e Bashkuara nuk kishin qëllim të përfshinin arsimin si një synim i vecantë i axhendës së zhvillimit post 2015 të OKB-së. Po pas dymbëdhjetë muajsh fushate ne jemi përzgjedhur. Tani ne duhet të lëvizim qeveritë e shteteve tona që të na mbështesin ne kur të merret vendimi përfundimtar nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara, në Shtatorin që vjen.

Por nuk duhet të jemi naivë. Ndërsa ne po diskutojmë synimet e zhvillimit për pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme, Synimi aktual i Zhvillimit të Mileniumit: Arsim baze i detyrueshem për të Gjithë Fëmijët deri në fund të 2015 nuk do të përmbushet. Vetëm 13 muaj larg afatit përfundimtar, ne botë ka

58 milion fëmijë që nuk ndjekin shkollën. Ata që janë akoma të përjashtuar janë të varfrit, vajzat dhe fëmijët më paaftësi, fëmijët në zonat rurale, ata nën konflikt dhe situata post konfliktuale dhe emigrantët.

Kjo është arsyeja pse përpjekjet tona mobilizuese duhet të ngrihen në një nivel tjetër. Pak javë më parë Bordi Drejtues i EI vendosi të zgjerojë Fushatën tonë Globale deri në Kongresin Botëror të Korrikut që vjen dhe mbase dhe përtej Kongresit. Si pjesë e Fushatës, dhe së bashku me Emisarin e OKB për Arsimin Global, kemi bërë pak ditë më parë një thirrje botërore ndaj anëtarësisë sonë për të firmosur një peticion : Të Ngrihemi për Shkollat. Ka një dritare mundësie për të vënë nën presion liderët botërorë për të mbajtur premtimet e tyre, për ta bërë 2015-tën vitin kur të gjithë fëmijët të sigurojnë të drejtën për të shkuar në shkollë, për të pasur një mësues të kualifikuar dhe për të mësuar.

Ndaj në këto kohë pasigurie ne, sindikatat e arsimit, duhet të qëndrojmë së bashku, në mbrojtje të vlerave që na bashkojnë ne në Ndërkombëtarin e Arsimit, duke promovuar arsim cilësor për një botë më të mirë. Ne, sindikatat e arsimit, duhet të qëndrojmë së bashku që arsimit cilësor dhe i financuar me fonde publike jo vetëm të ekzistojë por të lulëzojë në gjeneratat e ardhshme.

## Takime me prinderit ne shkollat

### “Naum Veqilharxhi” dhe “Shkolla e Re” Korçë, ne kuadrin e Projektit me AOb

Takime me prinderit e nxenesve që kane braktisur shkollën ose që janë në rrezik për ta braktisur atë, u zhvilluan me datën 18 dhjetor në dy shkollat e Korçës, “Shkolla e Re” dhe “Naum Veqilharxhi” në zbatim të Programit të Punës të Projektit që FSASH dhe SPASH janë duke zbatuar në këto shkolla me mbështetjen e Sindikates Holandeze të Arsimit, AOb.

Rreth 67 prinder, mesues e nxenes, anetare të Grupeve të Monitorimit, nga të dyja shkollat, si edhe drejtoret e shkollave, Romeo Rapo dhe Albert Damianeci, si edhe Kryetari i SPASH, Nevrus Kaptelli, dhe Kordinatori i Projektit, Stavri Liko, moren pjesë në të dy takimet.

Drejtuesit e grupeve të Monitorimit të të dy shkollave, Mimoza Beqirllari dhe Xhemlin Koleci, mbajtën raporte



te hollesishme, duke u perqendruar tek puna e bere, e sidomos tek bashkepunimi me prinderit, duke nenvizuar rolin e rendesishem te tyre per rikthimin e femijeve ne shkollë dhe eliminimin e punes se femijeve. Ata permenden shembuj pozitive te prinderve qe, pas nje pune konkrete te mesusve e nxenesve, i kane kthyer femijet ne shkollë, por edhe problemet me te cilat po perballen me disa prinder qe akoma nuk po i kthejne femijet ne shkollë, duke u justifikuar me gjendjen e veshtire ekonomike e financiare te familjeve te tyre dhe nevojat qe ata kane per ndihmen edhe nga ana e femijeve.

Mesueset Eliberta Rrushi, Migena Thaka, Arta Meka and Esta Ballco, ne "Shkolla e Re" dhe mesueset Eleni Kocaqi, Luljeta Hoxhallari, Esmeralda Ryka dhe Eva Cenolli, ne shkollën "Naum Veqilharxhi", folen per eksperiencat e tyre me prinderit e femijeve te grupeve respektive, per rezultatet e arritura dhe planet konkrete qe kane per te ardhmen.

Ato permenden edhe rezultatet e arritura deri tani ne kete proces: 2 nxenes te tjere ne shkollën "Shkolla e Re" dhe 4 nxenes te tjere ne shkollën "Naum Veqilharxhi" kane nderprere punen dhe jane rikthyer ne shkollë, nderkohe qe 6 nxenes te tjere ne shkollën "Shkolla e Re" dhe 9 nxenes te tjere ne shkollën "Naum Veqilharxhi" kane dale nga rreziku i braktisjes se shkolles dhe jane integruar teresisht ne shkollë.

Prinderit qe e moren fjalen ne te dy shkollat theksuan se veshtiresite ekonomike e financiare te familjeve te tyre i kane detyruar ata qe t'u drejtohen femijeve per te punuar, por nderkohe ata vleresuan shume punen e mesuesve dhe nxenesve bashkemoshatare te femijeve te tyre, duke bere te mundur rikthimin e tyre ne shkollë.

**Ne shkollën "Shkolla e Re"**, mamaja e nxenesve Orgito dhe Florence Ibrahim, Brunilda Ibrahim; mamaja e nxenesve Suela dhe Anduena Kosturi, Mirela Kosturi, babai i nxeneses Paula Merdiku, Olsi Merdiku; dhe mamaja e nxenesit Ronaldo Merdiku, Donika Merdiku; folen per veshtiresite ekonomike e financiare me te cilat perballen familjet e tyre, si shkaku kryesor qe femijet e tyre kane braktisur shkollën,

Por, ne te njejtën kohe, ato premtuan se do t'i perballojne vete veshtiresite dhe do t'i sjellin femijet ne shkollë.

Prinderit e tjere qe e moren fjalen ne kete takim, gjithashtu, folen per veshtiresite ekonomike e financiare te familjeve te

tyre, por shume shembuj te paraqitur nga mesues, nxenes e prinder te tjere u treguan atyre se te gjitha veshtiresite mund te kaperehen, po te vleresohet maksimalisht detyrimi per t'i cuar femijet ne shkollë.

**Ne shkollën "Naum Veqilharxhi"** mamaja e nxenesve Nikolin dhe Kristian Cardhaku, Shpresa Cardhaku; babai i nxeneses Marinela Latka, Arben Latka; babai i nxeneses, Brunilda Hysen, Vaso Hysen; nena e nxeneses Ela Mustafa, Brajana Mustafa; mamaja e nxenesve Jani dhe Marie Rrushi, Vera Rrushi; folen mbi situaten e femijeve te tyre, vleresuan shume punen e mesuesve dhe nxenesve te kesaj shkolle dhe te klasave perkatese me femijet e tyre dhe premtuan se do t'i sjellin femijet ne shkollë.



Ato vleresuan, sidomos ndihmen me tekste dhe mjete shkollore, te cilat jane bere te mundura, sidomos me ndihmen e sindikates se Holandes, AOb dhe kerkuan te shikohet mundesia per ndonje ndihme financiare ose ndonje vend pune te pakten per njerin prej prinderve te ketyre femijeve.

Problem ishte se disa prinder te femijeve qe kane braktisur shkollën, nuk erdhen ne kete mbledhje, edhe pse ishin njoftuar dhe kishin premtuar se do te vinin te degjonin mesuesit dhe nxenesit bashkemoshatare te femijeve te tyre. Ne keto kushte, u diskutua dhe u miratua nje program i vecante per te riorganizuar punen me grupe per t'i takuar keta prinder dhe per t'i binduar ata qe te sjellin femijet

ne shkollë.

Duke folur ne emer te sindikatave te arsimit, FSASH dhe SPASH, z. Nevruz Kaptelli, vleresoi punen e bere nga Grupet e Monitorimit dhe nga te gjithë mesuesit dhe nxenesit e te dyja shkollave, si edhe rolin e prinderve qe i kane rikthyer femijet e tyre ne shkollë dhe kerkoi forcimin e bashkepunimit dhe pune individuale, ashtu sic u vendos ne keto takime, me prinderit e nxenesve qe akoma nuk jane rikthyer ne shkollë.

Ai vleresoi, gjithashtu, edhe sindikaten e arsimit te Holandes, AOb, per mbeshtetjen e vazhdueshme te dy sindikatave tona te arsimit, ne punen e tyre per mbajtjen e te gjithë nxenesve ne shkollë dhe eliminimin e punes se femijeve, duke vleresuar

shume edhe kontributin per te pajisur me tekste e mjete shkollore te 80 nxenesve nga te dy shkollat, duke premtuar, ne te njejtën kohe, se edhe SPASH e FSASH, do rrisin kontributin e tyre per te ndihmuar sa me shume nxenes ne kete drejtim.

Takime te vecanta u organizuan me kete rast edhe me anetaret e Grupeve te Monitorimit ne te dyja shkollat, ku u diskutuan detyrat konkrete qe dalin nga keto takime dhe u nxoren disa konkluzione per permiresimin e metejshem te punes se tyre ne vijim, me synim organizimin me nivel te te gjitha aktiviteve te percaktuara per vitin 2015 dhe realizimin e te gjitha objektivave te percaktuara ne kuadrin e ketij Projekti.

## Takime me prinderit ne shkollat "Ahmet Zogu" dhe "Halit Cota", Bathore, ne kuadrin e Projektit me GEW

Ne vijim te zbatimit te Projektit qe dy sindikatat tona te arsimit, FSASH dhe SPASH, me Fondacionin e Sindikates Gjermane te Arsimit, GEW, "Femijeri e Bukur, Arsimit ne Vend te Punes se Femijeve", me datat 19 dhe 20 nentor 2014, u organizuan takimet me prinderit e nxenesve qe kane braktisur shkollen ose jane ne rrezik per ta braktisur ate ne dy shkollat "Ahmet

edhe disa prinder qe akoma i angazhojne femijet e tyre me pune dhe behen pengese per ardhjen e tyre ne shkollë.

Ata permenden edhe rezultatet e arritura deri ne kete periudhe: 2 nxenes te tjere ne shkollen "Ahmet Zogu" dhe 1 nxenes tjetër ne shkollen "Halit Cota" kane nderprere punen dhe jane rikthyer ne shkollë, nderkohe qe 4 nxenes te tjere ne

ne shkollen "Halit Cota", Perparim Murati, permenden se veshtiresite ekonomike e financiare te disa familjeve i detyrojne disa prinder qe t'u drejtohen femijeve te tyre qe t'i ndihmojne, per te siguruar te ardhurat e nevojeshme per mbijetesën e familjeve te tyre, qofte edhe duke nderprere shkollen.

Ata folen, gjithashtu, per rolin shume pozitive te prinderve qe jane anetare te Grupeve te Monitorimit dhe perpjekjet qe ata jane duke bere, ne bashkepunim me mesuesit dhe nxenesit, per t'i bindur keta prinder qe t'i dergojne femijet e tyre ne shkollë, pavaresisht nga veshtiresite me te cilat jane duke u ndeshur.

Drektori i shkolles "Ahmet Zogu", Azem Kovaci, dhe mesuesit Drita Cerpja, Agim Lilollari, Gazmend Halili, Izet Nabolli, si edhe Drejtore e shkolles "Halit Cota", Mahmut Ajazi dhe mesuesit Dila Vuksaj, Fabjona Gjuta, Marie Frroku, Bukurie Ajazi, perfaqesues te Grupeve te Monitorimit nga te dyja shkollat, folen mbi eksperiencat e tyre ne punen me prinderit e nxenesve qe kane braktisur shkollen, rezultatet qe kane arritur dhe problemet me te cilat ata jane ballafaquar, sidomos ne lidhje me disa nxenes qe kane patur me shume probleme familjare.

**Ne shkollen "Ahmet Zogu"**, prindi Rustem Nezha, premtoi se, jo vetem do te sjelle ne shkollë dy femijet e tij, por edhe te jape kontributin e tij, se bashku me mesuesit dhe nxenesit, per te ndikuar qe edhe prinderit e tjere t'i sjellin femijet e tyre ne shkollë.

Flutura Demacaj, mamaja e nxenesit Kletis Demacaj, i falenderoi mesuesit dhe nxenesit qe kane punuar me djalin e saj dhe e kthyen ate ne shkollë, duke premtuar qe edhe ajo do te mundohet te jap shembullin e saj edhe tek prinder te tjere te ketyre femijeve qe kane braktisur shkollen.

Po keshtu edhe prinderit Florian Kola, Ferit Sufa etj, kane dhene shembullin e vete duke i sjelle femijet e tyre ne shkollë, duke theksuar se, jo vetem kushtet ekonomike e financiare por edhe mentaliteti i disa prinderve, sidomos ndaj vajzave ne klasat e teta e te nenta, i pengon ato qe te vazhdojne shkollen rregullisht, gje qe duhet te terheq me shume vemendjene edhe te mesusve e nxenesve te angazhuar ne kete projekt.



Zogu" dhe "Halit Cota" ne Bathore.

Rreth 70 prinder, si edhe mesues e nxenes, sidomos nga radhet e atyre qe jane te angazhuar ne Grupet e Monitorimit, moren pjese ne te dy takimet.

Drejtoret e te dy shkollave, Azem Kovaci e Mahmut Ajazi, si edhe Kryetaret e FSASH, Xhafer Dobrushu, dhe SPASH, Nevrus Kaptelli, moren pjese, gjithashtu, ne te dy takimet.

Drejtuesit e Grupeve te Monitorimit, Bukurosh Hoxha dhe Hysen Koldashi, informuan per punen e bere ne zbatim te ketij Projekti, duke permendur edhe rezultatet dhe detyrat qe duhet te ndiqen ne vazhdimesi per realizimin e objektivave te Projektit.

Ata u perqendruan sidomos tek bashkepunimi me prinderit dhe roli i tyre per rikthimin e nxenesve ne shkollë dhe eliminimin e punes se femijeve. Ata permenden shembuj pozitive te disa prinderve qe, pas nje pune konkrete te mesusve e nxenesve me ta, i kane kthyer femijet ne shkollë, si

shkollen "Ahmet Zogu" dhe 3 nxenes tjetër ne shkollen "Halit Cota" jane jasht rrezikut per braktisjen e shkolles dhe jane integruar teresisht ne shkollë.

Ata permenden edhe veshtiresite e shumta me te cilat ndeshen mesuesit, nxenesit dhe te gjithë aktoret e tjere qe jane duke u marre me rikthimin e nxenesve ne shkollë dhe eliminimin e punes se femijeve, duke shpjeguar se jo vetem mesuesit dhe nxenesit e angazhuar ne Grupet e Monitorimit, por edhe te gjithë mesuesit e tjere te ketyre shkollave jane te angazhuar konkretisht ne pune individuale me nxenesit objekt i ketij Projekti ne pune shtese dhe aktivitete te shumta per te permiresuar situaten, duke vleresuar shume edhe ndihmen e Fondacionit te sindikates Gjermane te arsimit, GEW per mbeshtetjen e sindikatave tona te arsimit, FSASH dhe SPASH ne kete angazhim.

Kryetari i Keshillit te Prinderve ne shkollen "Ahmet Zogu", Kujtim Hysneli, dhe perfaqesuesi i Keshillit te Prinderve

**Ne shkollen “Halit Cota”,** prinderit Nazmie Peposhi, mamaja e nxenesit Xhemis Peposhi, dhe Kujtime Fatmiri, mamaja e nxeneses Blerta Fatmiri, vleresuan shume punen e mesuesve dhe nxenesve qe kane punuar me femijet e tyre dhe prematuan se do t'i sjellin rregullisht femijet e tyre ne shkolle.

Prindi Perparim Murati shpjegoi pervojen e tij me dy femijet, Bruklin dhe Elidion Mjurati, te cilet, pasi e kishin braktisur shkollen dhe ishin te angazhuar ne pune, tanime vazhdojne shkollen rregullisht, duke patur edhe rezultate te mira ne mesime.

Po, keshtu prinderit, Nexhmije Caka, Violeta Gjoku, Hyret Xhediku etj, vleresuan shume ndihmen qe u eshte dhene femijeve te tyre edhe me libra e mjete te tjera mesimore, me kontributin e ketij projekti, duke premtuar se do t'i sjellin rregullisht femijet e tyre ne shkolle, duke kerkuar nderkohe qe te shikohet mundesia edhe per ndonje ndihme financiare, per shkak te kushteve te veshtira qe kane per sigurimin e te ardhurave per mbajtjen e

familjeve te tyre.

Kryetaret e FSASH dhe SPASH, Xhafer Dobrushu dhe Nevruz Kaptelli, vleresuan punen e bere dhe rezultatet e



arritura dhe shrehen mendimet e tyre ne lidhje me rolin e rendesishem te prinderve per dergimin e femijeve ne shkolle dhe eliminimin e punes se femijeve, duke theksuar nevojen per nje bashkepunim me te mire me prinderit ne te ardhmen.

Te gjitha pjesemarresit vleresuan shume mbeshtetjen e Fondacionit te Sindikates Gjermane te Arsimit, GEW, “Femijeri e Bukur, Arsimit ne Vend te

Punes se Femijeve”, dhe prematuan qe FSASH dhe SPASH, do te vazhdojne te mbeshtesin nxenesit e ketyre shkollave edhe me kontribute modeste te vetat, sidomos per nxenesit dhe familjet me ne nevoje te kesaj zone.

## HOMAZH MIKUT TONE TE PAHARRUAR, SOTIR BUDO



Me 4 nentor 2014, si pasoje e gjendjes shendetesore te renduar dhe nje ataku kardiak, nderroi jete Mesuesi i mirenjohur, aktivisti i palodhur i Federates se Sindikatave te arsimit, FSASH, Sotir Budo.

Sotiri lindi me 10 janar 1926 ne fshatin Postenan te Leskovikut, ne nje familje me tradita dhe ndjenja te thella atdhetdashurie. Rrethi familjar i Sotirit shquhej e respektohej nga fshati dhe krahina per thjeshtesi, ndershmeri, bujari; dallohej nga kembengulja per t'u arsimuar, per te ruajtur e kultivuar

traditat kulturore e patriotike te zones e mbare Gjirokastrës. Ne kete mjedis u rrit dhe u formua edhe Sotiri.

Si edhe pjestaret e tjere te familjes se tij, edhe Sotiri, ne moshe fare te re, mori pjese aktive ne Levizjen Nacional-Clirimtare, duke filluar nga grupet e te rinjve deri ne formacionet e medha te rezistences ne terren. Atje ku duheshin ndihmuar te plagosurit, atje ku kerkohej buke dhe ushqim per luftetaret dhe familjet e varfera, atje ku duhej te siguroheshin arme e municione per partizanet, atje ku zhvilloheshin kurset kunder analfabetizmit, atje ku punohej per te sheruar plaget e luftes dhe rindertimin e fshatit e te krahines, atje gjendej gjithnje edhe i riu SotirBudo.

Mbas clirimit te vendit, Sotiri ndoqi rrugen e punes e te shkollimit, u formua si nje kuader i spikatur rinie dhe me kalimin e viteve iu perkushtua fushes se kultures masive e te arsimit ne Tirane, derisa doli ne pension.

Per me shume se 20 vjet, Sotir Budo, apo xha Sotiri, sic e quanin qindra mesues te shkollave te Tiranës, dha ndihmesen e tij te pakursyer ne organizimin dhe mbarevajtjen e levizjes sindikale te kryeqytetit,

vecanerisht ne veprimtarine e Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences.

Xha Sotiri sfidoi per dy dekada semundjen dhe moshen. Ne te ftohtit e dimrit dhe ditet me vape perveluese, ne ditet me shi dhe re, xha Sotirin e gjeje ne oborret dhe mjediset e shkollave duke shperndare “ Tribunen Sindikale” dhe botime te tjera te FSASH, e gjeje duke biseduar me anetaret e keshillave sindikale, me mesuesit, me punetoret dhe rojet, ku interesohej per shqetesimet dhe kerkesat e tyre. Te merrej me njerezit, te ndihmonte ne zgjidhjen e shqetesimeve dhe kerkesave te tyre, ky ishte pasioni i tij. Keto shqetesime dhe kerkesa i parashtronte ne Seksionin Sindikal apo ne Federate dhe, me pasionin dhe kembenguljen qe e karakterizonte, insistonte deri ne plotesimin e tyre. Prandaj sindikalistet e mireprisnin xha Sotirin dhe shqetesoheshin kur ai u mungonte.

Tani xha Sotiri do te na mungoje te gjithethe, por ai do te mbetet i paharruar ne kujtesen tone.

Lamtumire miku yne.

**Xhafer Dobrushu, Fatmir Bezati, Stavri Liko, Fatbardha Keco, Majlinda Ziu, Lumturi Mataj.**



**TRIBUNA**

**SINDIKALE**

